



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 509 Prot.

Tiranë, më 07 / 04 / 2020

V E N D I M

Nr. 34, Datë 07 / 04 / 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.130 Regj, datë 11.10.2019, të një grupi personash¹, kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Tiranë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a) Korçë dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE), me pretendim diskriminimin për shkak të “*gjendjes ekonomike*²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), janë shprehur se, që prej vitit 2014 janë akomoduar nga Bashkia Korçë tek ndërtesa e ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore. Fillimisht ata janë furnizuar me energji elektrike nëpërmjet një kontrate kolektive, të lidhur me Bashkinë Korçë, të cilës i paguanin një shumë të caktuar, fikse për furnizimin me ujë dhe me energji. Ata citojnë se: “*Në vitin 2017, pasi lidhëm kontratën e huapërdorjes me Bashkinë Korçë, nga ana e saj u mendua që ne të lidhnim kontrata individuale me OSHEE-në për furnizimin me energji elektrike*”.

¹ Subjektet ankues: B. K, A. N dhe L. N.

² Subjektet ankues kanë depozituar dokumentacion se trajtohen me ndihmë ekonomike.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në këtë kontekst, sipas Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, duhet të plotësohet dokumentacioni si më poshtë citohet:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike.
2. Vërtetim i Identitetit.
3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë: akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, etj.
4. Projekti elektrik i objektit.
5. Fotokopje e Çertifikatës së regjistrimit (për subjektet jo familjare)
6. Gentplani i vendndodhjes së objektit, shkalla 1:1000 (të specifikuar koordinatat e konturit të sipërfaqes së objektit, dy kopje).
7. Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, lëshuar nga inxhinierë elektrikë të pajisur me licensë.

Ankuesit shprehen se për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar janë asistuar dhe ndihmuar nga specialistët e Bashkisë Korçë.

Pikat 4.2 dhe 4.3 e kësaj Rregulloreje kanë të parashikuar procedurën lidhur me punimet dhe shërbimet që do të paguhet, si dhe mënyrën se si do të paguhet nga aplikanti.

Problematika e hasur prej tyre, konsiston në faktin se, referuar po kësaj Rregulloreje, Dega e OSHEE Korçë, u ka kërkuar atyre që të paguanin në avancë shumën prej 22.000 lekësh për lidhjen e kontratës.

Ankuesit, të ndodhur në situatë ekonomike të vështirë, (ata kanë vërtetuar me dokumentacion se të ardhurat e tyre familjare sigurohen vetëm nga ndihma ekonomike), e kanë të pamundur të paguajnë në mënyrë të menjëhershme shumën prej 22.000 lekësh, duke qenë se nuk kanë të ardhura ekonomike të mjaftueshme.

Në përfundim të ankesës së tyre, subjektet ankues kërkojnë që nga ana e OSHEE Tiranë dhe OSHEE Korçë, të merret në konsideratë fakti që ata janë në pamundësi financiare për të paguar në mënyrë të menjëhershme shumën prej 22.000 lekësh për lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike, dhe të mundësohet pagesa e kësaj shume në një shtrirje kohore të arsyeshme, në përputhje me të ardhurat e tyre ekonomike (vetëm ndihma ekonomike, në rastin konkret).

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr.1552/1 prot., datë 22.10.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion OSHEE sh.a, OSHEE sh.a Korçë dhe ERE, lidhur me pretendimin e ankuesve.
- Nëpërmjet shkresës me nr.643/1 prot, datë 29.10.2019, OSHEE sh.a Korçë ka dërguar parashtrimet e veta duke cituar se:

“Çdo individ ose institucion i cili paraqitet pranë Zyrave të Kujdesit ndaj Klientit të Kompanisë për të aplikuar për lidhje të re me energji elektrike duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar. Pas dorëzimit të tij, bëhet aplikimi për lidhjen e re. Pas marrjes së aplikimit Departamenti i Lidhjeve të Reja kryen azhurnimin në terren dhe nga informacionet e marra nga ky azhurnim si dhe nga projekti elektrik në të cilin përcaktohet fuqia e cila do të instalohet në atë objekt përpilohet edhe preventivi i pagesës për aplikimin e realizuar. Pasi aplikuesi kryen pagesën e këtij preventivi, i cili sipas Rregullores së OSHEE sh.a nuk ka akses për t’u aplikuar si Akt-Marrëveshje për pagesën me këste nga ana e aplikuesit, bëhet ekzekutimi në terren i lidhjes me energji për abonentin ”

OSHEE sh.a Korçë, thekson faktin se ata kanë zbatuar me përpikëmeri procedurën e përcaktuar në Rregulloren e OSHEE sh.a dhe se për aplikuesit do të ndërmerren masa të menjëhershme për ofrimin e energjisë elektrike, sapo ata të realizojnë pagesën e preventivit.

- Nëpërmjet shkresës me nr.21618/2 prot., datë 15.11.2019, OSHEE sh.a ka informuar KMD se:

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

“Shoqëria OSHEE sh.a është një prej operatorëve më të rëndësishëm të tregut të energjisë elektrike, e licensuar nga ERE për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. OSHEE sh.a, si institucioni përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, përdor lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe efikasitetin e energjisë, zbaton me përpikëmeri ligjin nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, aktet nënligjore në funksion të tij dhe vendimet e ERE-s.

Ndër të tjera, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, ERE ka miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të Komisionerëve të ERE, ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016 të Bordit të Komisionerëve të ERE, “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”.

Neni 4.2 i kësaj Rregulloreje përcakton kostot që lidhen me shërbimet që do të kryhen nga OSHEE sh.a. Gjithashtu, referuar nenit 4.3 të kësaj Rregulloreje, OSHEE sh.a zbaton me përpikëmeri praktikën e pagesës së plotë në avancë, për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese”

OSHEE sh.a ka theksuar se mirëkupton situatën me të cilën përballen subjektet ankues, por Shoqëria ndodhet në pozitën e zbatimit të dispozitave të Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, sipas kushteve të përcaktuara në këtë akt rregullator.

2. Në vijim të procedurës së ndjekur për shqyrtimin e ankesës, si dhe në zbatim të Urdhërit nr.217, datë 14.11.2019 të Komisionerit, me datë 11.12.2019, pranë ambjenteve të Shoqërisë OSHEE sh.a, u realizua inspektimi i cili kishte si objekt të tij marrjen e informacionit drejtëpërdrejtë nga Shoqëria si dhe dokumentacionin shkresor përkatës.

Gjatë inspektimit, nga ana e përfaqësuesit të kësaj Shoqërie, z.A.A, me detyrë Koordinator për të Drejtën e Informimit, u theksua se: *“OSHEE sh.a si operator i rëndësishëm në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe si Shoqëri tregtare, nuk është në kushtet për të propozuar ndryshim legjislativ për përfitimin e lidhjeve të reja për klientët në nevojë. Këto propozime ndërmerren nga ERE dhe pastaj bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar nga OSHEE sh.a”.*

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri me datë 13.01.2020⁵ realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: përfaqësuesit të subjekteve ankues, z.G.S dhe njëres palë kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit të OSHEE sh.a , z.A.A. Nga ana e ERE-s nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Gjatë seancës dëgjimore, palët e pranishme iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

4. Ndërkaq, në vijim të seancës dëgjimore, si dhe në zbatim të Urdhërit nr.8, datë 14.01.2020 të Komisionerit, pranë ambjenteve të ERE-s, me datë 23.01.2020, u realizua inspektimi, i

⁵ Referuar “Njoftimit për seancë dëgjimore” me nr.1985 prot., datë 30.12.2019, të Komisionerit.

cili kishte si objekt të tij marrjen e informacionit drejtëpërdrejtë nga ana e ERE-s, lidhur me kërkesën e KMD për mundësinë e konsiderimit prej tyre, të shtrirjes në kohë dhe me këste, të pagesës prej 22.000 lekësh për lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike, në përpunje me të ardhurat ekonomike të subjekteve ankues.

Gjatë takimit me përfaqësuesit e ERE-s, znj.E.N dhe z.E.Sh, u dakordësua që përgjigjja zyrtare e tyre lidhur me sa kërkohet nga KMD, të dërgohej në ditët në vijim.

- Njëpërmjet shkresës me nr.71/1 prot., datë 04.02.2020, ERE informon Komisionerin se ata kanë kërkuar opinion lidhur me rastin në fjalë nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). ERE ka përmendur dhe precedentin e suksesshëm të mbledhjes nga OSHEE sh.a të detyrimeve të prapambetura në lidhje me pagesat e energjisë elektrike nga klientët debitorë njëpërmjet kontratave afatgjata me këste.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga ankuesit.

a) Lidhur me pretendimin e ankuesve për trajtim të padrejtë nga ana e OSHEE sh.a dhe OSHEE sh.a Korçë.

Subjektet ankues që prej vitit 2014 janë akomoduar nga Bashkia Korçë tek ndërtesa e ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore, ku dhe jetojnë aktualisht. Fillimisht ata janë furnizuar me energji elektrike njëpërmjet një kontrate kolektive, të lidhur me Bashkinë Korçë, të cilës i paguanin një shumë të caktuar për furnizimin me ujë dhe me energji. Në vitin 2017 banorët lidhën kontrata huapërdorjeje me Bashkinë Korçë. Në këto kushte, banorët u orientuan nga ana e Bashkisë të lidhnim kontrata individuale me OSHEE-në për furnizimin me energji elektrike.

Bazuar në Rregulloren “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes⁶”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, subjektet ankues kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, për të cilin, sikurse është pranuar nga palët në këtë proces administrativ, janë asistuar dhe ndihmuar nga specialistët e Bashkisë Korçë.

Pikat 4.2 dhe 4.3 e kësaj Rregulloreje kanë të parashikuar procedurën lidhur me punimet dhe shërbimet që do të paguhet, si dhe mënyrën se si do të paguhet nga aplikanti, dhe konkretisht, lidhur me mënyrën e realizimit të pagesës, është përcaktuar se:

- i. Aplikanti duhet të kryejë një pagesë për tarifën e lidhjes së re, e cila mbulon shpenzimet e përcaktuara në këtë akt.

⁶ Miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

- ii. Aplikanti duhet të mbulojë vetë shpenzimet e të gjitha punimeve dhe paisjeve shtesë që janë të nevojshme për të realizuar lidhjen e re.
- iii. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të zbatojë praktikën e pagesës së plotë në avancë për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese".

Lidhur me kërkesën e OSHEE sh.a Korçë/OSHEE sh.a ndaj ankuesve, për pagesën e plotë në avancë për lidhjen e re, Komisioneri vlerëson se, kjo kërkesë vjen si zbatim i drejtëpërdrejtë i aktit rregullator të këtij Operatori. Për sa kohë që Rregullorja e përcakton si detyruese një kërkesë të tillë, OSHEE sh.a është e detyruar ta zbatojë atë.

Pra, në këtë rast nuk jemi para shkeljes së të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" nga ana e OSHEE sh.a Korçë dhe OSHEE sh.a.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se subjektet ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të padrejtë apo diskriminuese nga ana e OSHEE sh.a Korçë dhe OSHEE sh.a, për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, për sa kohë ata kanë zbatuar Rregulloren, e cila miratohet me Vendim të Bordit të ERE.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri do të analizojë dhe shqyrtojë nëse vetë akti rregullator, Rregullorja "Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes" është diskriminuese ndaj subjekteve ankues, bazuar pikërisht në pamundësinë e tyre financiare për të realizuar pagesën e plotë dhe në avancë të lidhjes së re.

b) Lidhur me pretendimin e ankuesve për trajtim të padrejtë nga ana e ERE-s.

Rregullorja "Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes" është miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE dhe është detyruese për OSHEE sh.a.

Në pjesën e VI "Dispozita Përfundimtare", në pikën 6.2 të saj, ka parashikuar se:

"Kjo rregullore është objekt rishikimi, me vendim të Bordit të ERE-s, sipas Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s".

Pra, sikundër dhe shihet qartë, tagrin dhe kompetencat për ndryshimin e kësaj Rregulloreje i ka ERE. Rregullorja "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", është miratuar me Vendimin nr.96, datë 17.06.2016 të ERE-s.

Neni 3, pika 1, germa d) e saj ka përcaktuar se:

" Kjo rregullore përcakton procedurat e përgjithshme që aplikohen nga ERE gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, lidhur me: ...hartimin dhe rishikimin e akteve nënligjore".

Neni 7, pika 2 e saj parashikon se:

"Bordi është organi vendimmarrës i ERE-s që përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë së ERE dhe vendos për çështjet që kërkojnë miratimin e ERE-s. Ai vepron si organ kolegjal".

Po ashtu, në pjesën VII “Hartimi i akteve nënligjore”, në nenin 26, pikën 1, përcakton në mënyrë të qartë se:

“Për hartimin apo rishikimin e një akti nënligjor që ka të bëjë me ushtrimin nga ana e ERE-s të autoritetit në drejtim të miratimit të akteve nënligjore, me iniciativën e vet apo me propozim të subjekteve që kanë të drejtën e hartimit të një akti objekt i miratimit nga ERE, Kryetari, në konsultim me anëtarët e Bordit urdhëron ngritjen e një grupi pune i cili përgatit projekt-aktin dhe propozon shqyrtimin në Bord”.

Referuar përcaktimeve të Rregullores aktuale “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes⁷”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, aplikantët/subjektet ankues në rastin konkret, detyrohen të kryejnë pagesën prej 22.000 lekësh, për tarifën e lidhjes së re, e cila duhet të realizohet e plotë dhe në avancë prej tyre.

Pranohet prej palëve në proces: OSHEE sh.a, OSHEE sh.a Korçë dhe ERE se subjektet ankues janë realisht në pamundësi pagese të kësaj shume, në mënyrë të menjehershme, të plotë dhe në avancë, pasi ata faktojnë se janë në pamundësi financiare.

Nga ana tjetër, është fakt që parashikimi i pikës 4.3 të kësaj Rregulloreje trajton pa asnjë diferencim të gjithë aplikantët, duke mos patur në konsideratë aftësitë e tyre paguese, sa i takon tarifës së lidhjes së re.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri thekson se, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se ata individë që janë në situata të ndryshme duhet të marrin trajtim të ndryshëm deri në masën që nevojitet për t’i lejuar të gëzojnë mundësi të caktuara njësoj si të tjerët.

“Gjendja ekonomike” si “shkak i mbrojtur” nga LMD, duhet të merret në konsideratë gjatë kryerjes së praktikave të caktuara ose krijimit të rregullave të veçanta, dhe konkretisht në rastin e hartimit të kësaj Rregulloreje do të duhet të ishte konsideruar nga ana e ERE-s, sa i takon detyrimit të kësaj kategorie personash/aplikantësh, në pamundësi financiare, sikurse janë dhe subjektet ankues, të realizojnë pagesën e plotë dhe në avancë të shumës prej 22.000 lekësh si tarifë për lidhjen e re; njëllon si kategoria e aplikantëve të cilët janë në mundësi financiare për ta kryer një pagesë të tillë.

Edhe e drejta e BE-së edhe jurisprudenca e KEDNJ-së pranojnë se diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta, por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme. Ky i fundit quhet diskriminim “i tërthortë”, sepse nuk është trajtimi që ndryshon por janë më tepër pasojat e atij trajtimi, që do të ndjehen ndryshe nga njerëzit me karakteristika të ndryshme.

⁷ Miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

Kjo ndodh kur kriter apo praktikë në dukje neutrale, do t'i vendoste personat që posedojnë shkaku e mbrojtur, në një disavantazh të veçantë në krahasim me persona të tjerë.

Elementët e diskriminimit të tërthortë janë si më poshtë:

- një rregull, kriter apo praktikë neutrale;
- që prek një grup të përcaktuar nga një “shkak i mbrojtur” në një mënyrë shumë më negative;
- duke krahasuar të tjerët në një situatë të ngjashme.

Kriteri i parë i identifikueshëm është një rregull, kriter ose praktike neutrale. Me fjalë të tjera, duhet të ketë një kriter që zbatohet për të gjithë. Në rastin konkret, pika 4.3 e Rregullores Rregullores aktuale “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes⁸”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, “prima facie” trajton të gjithë aplikantët në mënyrë të barabartë dhe të padiferencuar.

Kriteri i dytë i identifikueshëm është se dispozita, kriteri ose praktika neutrale e vendos një “grup të mbrojtur” në një disavantazh të caktuar. Për këtë arsye diskriminimi i tërthortë ndryshon nga diskriminimi i drejtpërdrejtë sepse e zhvendos fokusin larg nga trajtimi i ndryshëm për të parë efektet e ndryshme. Grupi i ankuesve që janë në pamundësi financiare për shkak të gjendjes së tyre ekonomike; por dhe e gjithë kategoria e personave të tjerë në kushte të njëjta me ta, bëjnë pjesë në grupin e margjinalizuar që gëzojnë shkaku e mbrojtur, krahasuar me personat/aplikantët e tjerë që nuk janë në pamundësi ekonomike.

Të gjitha format e diskriminimit të tërthortë janë subjekt i një mbrojtjeje, bazuar në një justifikim objektiv pavarësisht nëse pretendimi bazohet në KEDNJ-në ose në të drejtën Evropiane.

Subjektet ankues (dhe të gjithë aplikantët e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ta), referuar dokumentacionit provues, klasifikohen në ato shtresa vulnerabël, në pamundësi ekonomike për të siguruar përmbushjen e nevojave më minimale të një jetese normale.

Legjislacioni i Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesit Social mbron familjen në përgjithsi dhe individin në veçanti nga pikëpamja ekonomike, duke i siguruar një ndihmë ekonomike mujore, nëse ndodhet në kushtet e mungesës së plotë të të ardhurave ose i ka ato të pamjaftueshme.

Subjektet ankues janë përfitues bazuar në këtë legjislacion por sërish të ardhurat e vetme të tyre të cilat janë si rezultat ndihmës ekonomike, nuk mundësojnë përmbushjen e nevojave më minimale për një jetesë normale. Në këto kushte, ata e kanë të pamundur përballimin e pagesës së tarifës së lidhjes së re të Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike.

Kështu, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike të ankuesve për shkak të moslidhjes së kontratës së re, ardhur si pasojë e mospagesës së tarifës prej 22.000 lekësh është cënim i rëndë i kushteve thelbësore të jetesës, si dhe dhe goditje e rëndë për dinjitetin njerëzor.

Ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ka përcaktuar se kategoria e klientëve familjarë, të cilët për shkak të gjendjes sociale/ ekonomike, përfitojnë një status të veçantë sipas

⁸ Miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

kritereve dhe procedurave të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, kategorizohen si “klientë në nevojë”.

Në analizë të sa më sipër, subjektet ankues kategorizohen në kategorinë e caktuar të klientëve të energjisë elektrike të cilësuar si “klientë në nevojë”, pavarësisht faktit se ata ndodhen në fazën e aplikantëve, për t’u bërë “klientë”.

Në respektim të kategorisë së “klientëve në nevojë”, për analogji të rastit në shqyrtim, Komisioneri vlerëson pozitive të gjitha hapat e ndërmarra nga ana e ERE-s, nëpërmjet miratimit të Rregullores “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen me energji elektrike të klientëve në nevojë”, miratuar nëpërmjet Vendimit të Bordit të ERE-s me nr.246, datë 11.12.2018⁹.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri sheh të domosdoshme një ndërhyrje sa më të shpejtë nga ana e ERE-s lidhur me marrjen e masave për ndryshimin e pikës 4.3 të Rregullores aktuale “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes¹⁰”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, duke çliruar nga detyrimi dhe barra e pagesës së tarifës prej 22.000 lekësh kategorinë e aplikantëve që gëzojnë statusin “klientë në nevojë”, për sa kohë ata dokumentojnë dhe provojnë shkakun e mbrojtur. Në momentin që kësaj kategorie aplikantësh iu kërkohet realizimi i plotë dhe në avancë i pagesës së tarifës për lidhjen e re, atyre iu mohohet aksesimi dhe e drejta për t’u bërë klientë, pikërisht për shkak të pamundësisë së tyre financiare për ta realizuar atë.

Rregullorja “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, në nenin 37 të saj ka përcaktuar se: *“...ERE , për përshpejtim të një procesi, objekt i vendimmarrjes së Bordit, për aq sa lejohet nga ligji, aty ku ka një shkak të arsyeshëm, Bordi do të lejojë personelin teknik të trajtojë një çështje me procedurë të përshpejtuar apo me një procedurë të ndryshme nga kërkesat procedurale të përcaktuara në rregullat e veçanta, kur i sheh ato të papraktikueshme, të papërshtatshme ose të panevojshme, me kusht që ky proces të mos kufizojë të drejtat e palës, subjekt i procedurës së trajtuar nga Bordi”.*

Neni 38 i po kësaj Rregulloreje, përcakton se: *“Këto rregulla janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetin dhe funksionet ligjore të ERE-s. Në rast konflikti mes legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me autoritetin dhe kompetencat e ERE-s dhe këtyre rregullave, do të prevalojë legjislacioni në fuqi”.*

⁹ Referua Rregullores së ERE-s “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”, të cilën e gjen plotësisht të bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, si dhe në përputhje të plotë me parashikimet e LMD-së⁹. Kështu, në nenin 5 të kësaj draft rregulloreje janë vendosur detyrimet e shërbimit publik, si masë mbrojtëse për interesat e klientëve në nevojë⁹:

“Furnizuesi duhet të vendosi sisteme/procese që sigurojnë që klientët në nevojë, të regjistruar si të tillë, të mos u ndërpriten furnizimi me energji elektrike gjatë periudhave të caktuara gjatë të cilave gëzojnë statusin e klientit në nevojë.

...Klientët e regjistruar, sipas kritereve specifike, si të varur në mënyrë kritike nga energjia elektrike për jetën e tyre, nuk mund t’u ndërpriten furnizimi me energji elektrike për shkak të mospagesës së faturave të energjisë elektrike.

...Furnizimi me energji elektrike nuk mund të ndërpritet edhe në rastet kur klienti, ka paraqitur dhe është në proces të trajtimit të kërkesës së tij, për t’u klasifikuar si “klient në nevojë”.

¹⁰ Miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

Pra, edhe në kushtet aktuale në të cilat ndodhemi, kur ende nuk janë miratuar aktet nënligjore për kriteret dhe procedura për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyra e trajtimit të tyre, në zbatim të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektike”; neni 38 i Rregullores së ERE-s ka parashikuar që të zbatohet fryma e vetë ligjit dhe të prevalojnë përcaktimet e bëra në të.

Në këtë kontekst, ligji “Për Sektorin e Energjisë Elektike”, ka përcaktuar *inter alia* se kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë marrin në konsideratë klientët me të ardhura të ulëta, të cilët përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit të tyre të përhershëm, dhe se financimi për mbështetje të klientëve në nevojë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese, duke mos lejuar ndërfinancimin nga kategoritë e tjera të klientëve të energjisë elektrike.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ERE mund të iniciojë vetë, procedurën për ndryshimin e pikës 4.3 të Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, nëpërmjet miratimit me vendim Bordi, të heqjes së detyrimit të tarifës për lidhjen e re të kategorisë së personave të cilët janë në mundësi financiare për ta kryer një pagesë të tillë.

Neni 96 , po këtu parashikon se: *“Klientët familjarë, të cilët kanë përfituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 95, të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit të furnizimit universal, sipas parashikimeve të këtij ligji. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë fillon në ditën që klienti regjistrohet prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si klient në nevojë”*.

Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ERE, është organi kompetent i cili ka tagrin për ndryshimin e pikës 4.3 të Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, dhe pavarësisht faktit se ka marrë dijeni lidhur me këtë kërkesë të subjekteve ankues, nuk ka sjellë para Komisionerit asnjë provë që të ketë iniciuar një procedurë të tillë. ERE, me iniciativën e vet mund të ndërmerre hapa konkretë për ndryshimin e Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”.

Kodi i Procedurës Administrative¹¹ dhe Kodi i Punës, i ndryshuar¹², kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast ERE-s, e cila duhet të provonte se subjektet ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tyre.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të*

¹¹Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

¹²Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për çdo pretendim të ankuesve dhe u janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura.

Referuar barrës së proves sikurse është cituar dhe më lart në vendim, ERE duhet të provonte që parashikimi i bërë në pikën 4.3 të Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, ishte një masë e arsyeshme, objektive dhe proporcionale konform përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi; ose në të kundërt duhet të demonstronte vullnet për ta ndryshuar atë, duke konsideruar mundësinë për heqjen e këtij detyrimi për subjektet ankues, të cilët ndodhen në pamundësi financiare për ta paguar atë.

Nga ana e ERE-s nuk u soll asnjë dokument që të provonte se ata do të ndërmerrnin masa konkrete lidhur me sa është kërkuar. Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë krahasuar me të gjithë aplikantët e tjerë, pasi ata nuk ndodhen në kushte e rrethana të njëjta, me aplikantët e tjerë, pikërisht për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

2. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹³, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, si dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

¹³ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Në lidhje me pretendimin e ankuesve për diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*”, Komisioneri gjykon se “*gjendja ekonomike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjektet ankues kanë depozituar prova të cilat faktojnë se e mbartin atë. Kështu:

- Nëpërmjet dokumentit “Vërtetim”, lëshuar nga Bashkia Korçë me datë 30.09.2019, vërtetohet fakti se B.K trajtohet me ndihmë ekonomike në Njësinë Administrative nr.31, me shumën 1.800 lekë.
- Nëpërmjet dokumentit “Kartelë e punëkërkuarit të papunë”, lëshuar nga Zyra e Punësimit Korçë me datë 19.09.2019 vërtetohet fakti se L.N rezulton i papunë dhe për rrjedhojë trajtohet me ndihmë ekonomike.

Lidhur me sa më lart, subjektet ankues kanë dokumentuar se nuk posedojnë të ardhura të tjera financiare përveç asaj të përfituar nga pagesa e ndihmës ekonomike.

3. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në analizimin e fakteve sa më sipër, si dhe mbrojtjes ligjore që iu garantohet kategorisë së personave që duhet të trajtohen me status klienti në nevojë, për shkak të pamundësisë së tyre financiare; rezulton se subjektet ankues, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë përse i takon masave favorizuese që duhet të ishin ndërmarrë në favor të tyre.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit/grupit të individëve lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Përse më sipër, Komisioneri analizoi situatën e krijuar, duke iu referuar jo vetëm ankesës individuale të subjekteve ankues, por duke e shtrirë problematikën për të gjithë kategorinë e personave që përfitojnë statusin e “klientit në nevojë”, për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*”. Neni 18, i saj shpreh se: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*”.

Neni 52 i Kushtetutës në pikën 2, të tij¹⁴ parashikon se: “*Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarur nga vullneti i tij dher kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës ekonomike në kushtet e parashikuara në ligj*”. Kjo është një shprehje e mbrojtjes sociale, e realizuar përmes përmbushjes së objektivave social, dhe si e tillë realizimi i tyre është i lidhur

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu IV, Liritë dhe të Drejtat Ekonomike , Sociale dhe Kulturore.

ngushtësisht me detyrimin e shtetit për të mundësuar garantimin dhe sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore.

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹⁵ është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, i KEDNJ, "Ndalimi i diskriminimit", përcakton se : *"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër"*.

GJEDNJ-ja është shprehur se *"e drejta për të mos u diskriminuar kundër gëzimit të të drejtave të garantuara sipas KEDNJ-së dhunohet gjithashtu kur Shtetet... nuk i trajtojnë në mënyra të ndryshme personat, situatat e të cilëve janë shumë të ndryshme"*.

Po kështu, direktivat e BE-së për mbrojtjen nga diskriminimi parashikojnë shprehimisht mundësinë për veprime pozitive, duke përcaktuar se: *"Për të garantuar barazi të plotë në praktikë, parimi i trajtimit të barabartë nuk duhet t'i ndalojë Shtetet Anëtare nga pasja ose miratimi i masave konkrete për parandalimin ose kompensimin e disavantazheve të lidhura me "shkaqet e mbrojtura"¹⁶".*

Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Evropës lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike, në nenin 7 të saj, citon se: *" Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate për të mbrojtur konsumatorët dhe do të sigurojnë marrjen e masave adekuate mbrojtëse për të mbrojtur konsumatorët e cënueshëm. Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar do të definojë konceptin e konsumatorëve të cënueshëm, i cili do t'i referohet varfërisë dhe midis të tjerave duhet të ndalojë ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorët në raste kritike"*.

Neni 8, i po kësaj Direktive parashikon se: *"Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate sikundër janë formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energjinë, që sjell përfitime në sistemin e sigurimit social dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm të energjisë për konsumatorët e cënueshëm apo ofrimin e përkrahjes për përmirësimin e efikasitetit të energjisë..."*.

Lejueshmëria e marrjes së masave pozitive në favor të grupeve në disavantazh përforcohet më tej nga guidat e nxjerra nga disa prej organeve monitoruese përgjegjëse për interpretimin e traktateve të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Këto organe kanë theksuar se masa të tilla duhet

¹⁵ Në vijim do ti referohemi me shkurtesën KEDNJ. Ajo është ratifikuar nga RSH me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

¹⁶ GJEDNJ, *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (No. 34369/97), 6 Prill 2000, paragraf 44 (ECtHR, *Thlimmenos v. Greece* [GC] (No. 34369/97), 6 April 2000, para. 44). Po kështu, GJEDNJ, *Priti kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2346/02), 29 Prill 2002, paragraf 88 (ECtHR, *Pretty v. the United Kingdom* (No. 2346/02), 29 April 2002).

të jenë të përkohshme në natyrë, duke mos u zgjeruar në kohë dhe fushëveprim përtej çfarë është e nevojshme për trajtimin e pabarazisë në fjalë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në frymën e saj dhe në veçanti, në nenin 25 të saj shprehet se, e drejta për energji elektrike në vetvehte është një e drejtë themelore e njeriut që buron nga e drejta për një standard të përshtatshëm jetese.

Krijimi i mundësisë për t'u furnizuar me energji elektrike ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e jetesës së individit. Në këtë këndvështrim, kjo kategori aplikantësh, përfituesish të cilët konsiderohen si shtresë shoqërore vulnerabël, për shkak të pamundësisë së tyre ekonomike, duhet të gëzojnë një mbrojtje të veçantë, në mënyrë të diferencuar nga pjesa tjetër e aplikantëve, të cilët nuk janë në pamundësi financiare, me qëllim mbrojtjen maksimale të kësaj shtrese në nevojë.

Aksesi në burimet kryesore të jetës është një nevojë humane thelbësore dhe për rrjedhojë dhe një drejtë elementare për t'u respektuar. Mungesa e aksesit të plotë në këto burime është një goditje në dinjitetin e individit.

Mungesa e një skeme mbrojtëse efikase, kundrejt kësaj kategorie vulnerabël ka shkaktuar cenim të rëndë të së drejtës për aksesin në furnizimin me energji elektrike, gjë që ka vënë në vështirësi serioze përmbushjen e nevojave bazë të lidhura me ndriçimin, ruajtjen e shëndetit, aksesin në informacion etj.

Komisioneri thekson se, trajtimi i subjekteve ankues dhe i gjithë kategorisë së aplikantëve të ndodhur në kushtet e pamundësisë financiare për të realizuar pagesën për lidhjen e re, njëlloj me aplikantët në mundësi financiare për ta realizuar atë, duke mos i përjashtuar ata nga detyrimi për kryerjen e saj; bën që automatikisht ata të mbeten të pafurnizuar me energji elektrike, duke cënuar rëndë jo vetëm përmbushjen e nevojave më minimale të një jetese normale të kësaj kategorie përfituesish, por edhe dinjitetin e tyre.

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese¹⁷. Një shoqëri demokratike bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁸. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtje nga diskriminimi", është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi apo një grupi personash, mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 3/1, parashikon se: "*Diskriminim*" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji,

¹⁷Në Preambulën e Kushtetutës deklarohet: "*Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë*".

¹⁸Referuar nenit 3, pika 8 ,e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 3/3 i LMD ka sanksionuar se: “*“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”*

Neni 7, pika 1, e LMD parashikon se: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Neni 11, i LMD-së ka parashikuar dhe mundësinë e ndërmarrjes së një sërë masash pozitive, duke sanksionuar se: “*Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”.*

Në këtë kuadër, Komisioneri, konstaton se subjektet ankues, si dhe e gjithë kategoria e personave të cilët sipas përcaktimeve të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe akteve të tjera nënligjore, mund të rezultojnë përfitues të statusit të “klientit në nevojë”; janë vënë në pozita jo të favorshme në përputhje me parashikimet ligjore; duke iu mohuar paraprakisht mundësinë për lidhjen e kontratës së lidhjes së re dhe më pas duke iu mohuar atyre dhe mundësinë për të aksesuar në furnizimin me energji elektrike.

Pra, ata janë vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ERE, si organi kompetent për të ndryshuar pikën 4.3 të Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes¹⁹”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, të marrë masa konkrete për heqjen e kategorisë së aplikantëve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe janë në pamundësi financiare për të realizuar pagesën për lidhjen e re, nga detyrimi dhe barra për ta paguar atë.

¹⁹ Miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 dhe 52/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 17, të Kodit të Procedurës Administrative, nenin 3, pika 1 dhe 3, nenin 7, pika 1, nenin 11, nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pikat 9 dhe 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Përmbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të “gjendjes ekonomike”, të subjekteve ankues²⁰ dhe të gjithë kategorisë të aplikantëve të ndodhur në të njëtat kushte apo kushte të ngjashme me ta, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Tiranë dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a) Korçë.
2. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, për shkak të “gjendjes ekonomike”, të subjekteve ankues dhe të gjithë kategorisë të aplikantëve të ndodhur në të njëtat kushte apo kushte të ngjashme me ta, nga ana e Entit Rregullator të Energjisë (ERE).
3. ERE të marrë masa për ndryshimin e pikës 4.3 të Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes²¹”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, duke çliruar nga barra e pagesës së tarifës së lidhjes së re, aplikantët që trajtohen me statusin e “klientit në nevojë”, të cilët ndodhen në pamundësi financiare për ta realizuar atë.
4. ERE, brenda 30 ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi, të informojnë Komisionerin lidhur me masat e ndërmarra, për sa më sipër.
5. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Gjendja ekonomike

²⁰ Subjektet ankues: B. K, A. N dhe L. N.

²¹ Miratuar me Vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.